



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 73, Datë 10.03.2026

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “EB ENERGY” SH.P.K. PËR MARRJEN E
AUTORIZIMIT NGA ERE PËR VENDOSJEN E KUOTAVE SI MJET PËR
GARANTIMIN E PËRMBUSHJES SË DETYRIMIT NDAJ “PROCREDIT BANK”
SH.A.**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 3 dhe 8 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.03.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 842 prot., datë 10.03.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, “Mbi kërkesën e shoqërisë “EB ENERGY” sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj “ProCredit Bank” sh.a.”,

Konstatohet se,

- Shoqëria “EB ENERGY” sh.p.k., është licencuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 40, datë 14.02.2025, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
- Me shkresën nr. 765 prot., datë 02.03.2026, shoqëria ka paraqitur aplikimin dhe dokumentacionin për marrjen e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të saj, si mjet për të garantuar përmbushjen e detyrimit ndaj palës kredidhënëse “ProCredit Bank” sh.a.
- Në kuadër të kësaj kërkesë dhe në mbështetje të dispozitave të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021, shoqëria ka depozituar, ndër të tjera: Kontratat e Kredive Bankare respektivisht me nr. 2958 rep., nr. 1678 kol., datë 23.12.2024 dhe nr. 2959 rep., nr. 1679 kol., datë 23.12.2024, si dhe Marrëveshje Siguruese (Kontratë Pengu Kuota të shoqërisë) nr. 2960 kol., nr. 1680 rep., datë 23.12.2024, ku dakortësohet vendosja e pengut të 100% të kuotave të kredimarrësit.
- Konstatohet se si kontratat e kredive ashtu dhe ajo e pengut rezultojnë të nënshkruara përpara se shoqëria të ishte licencuar nga ERE, **pra përpara se shoqërisë t’i lindte detyrimi për të marrë autorizimin e ERE-s për këtë barrësim.**
- Në shkresën përcjellëse, shoqëria bën me dije se garancia do të realizohet përmes vendosjes së pengut mbi kuotat, ku në zbatim të nenit 4, pika 4.1 dhe 4.2 të Kontratës së Pengut mbi Kuotat, barra e sigurimit konsiderohet e plotë vetëm pas regjistrimit të saj në Regjistrin e Barrëve

Siguruese (RBS) dhe në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe nga shoqëria sqarohet se aktualisht procesi i barrës është i pakompletuar duke qenë se pritet miratimi i ERE-s.

- Për sa analizuar, rezulton se përveç faktit që kontratat janë nënshkruar përpara se subjekti të kishte marrë statusin si i licencuar, këto kontrata nuk kanë asnjë parashikim që lidhet me fillimin e afateve të tyre duke referuar detyrimin e marrjes së miratimit nga ERE, *kjo evidentuar si e pa parashikuar as në kontratat e kredisë e as në marrëveshjen e nënshkruar të pengut, si kusht i paracaktuar që duhet të plotësohet nga ana e kredimarrësit*. Gjithashtu, në *Aneksin 2, neni 3, pika 3.1 të kontratave të kredisë*, citohet se: “*Periudha gjatë të cilës kredia është në dispozicion të kredimarrësit për disbursim fillon në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate (23.12.2024) dhe mbaron brenda 30 ditëve*”, që do të thotë se kjo periudhë ka përfunduar në 23.01.2025, pra gjithashtu përpara se shoqërisë t’i lindte detyrimi për të marrë autorizimin në ERE për këtë barrësim.
- Në këto rrethana vlerësohet se ERE nuk mund të marrë në shqyrtim kërkesën e shoqërisë për sa kohë marrëdhënia juridike me bankën është krijuar përpara se shoqëria të merrte statusin e të licencuarit dhe të lindnin detyrimet përkatëse në kuadër të këtij statusi.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të mos marrë në shqyrtim kërkesën e shoqërisë “EB ENERGY” sh.p.k. për marrjen e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të kapitalit si mjet për garantimin e detyrimeve ndaj “ProCredit Bank” sh.a.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “EB ENERGY” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI